



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE

Njoftim nga takimi i kryetarit me drejtorët e komunës
Qeveria komunale ndan 50 mijë euro për rrënimin e objekteve pa leje

13 shkurt 2013, Prizren

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Transparenca online e komunës së Prizrenit" ka marrë pjesë në mbledhjen e radhës të kryetarit të komunës, Ramadan Muja me drejtorët komunal, në të cilin janë miratuar disa konkluzione.

Qeveria komunale e Prizrenit me kërkesën e Drejtorisë së Inspektorateve, ka nxjerrë konkluzionin për lejimin e shpalljes së tenderit për përzgjedhjen e operatorit ekonomik që do të merret me ekzekutimin e ndërtimeve pa leje në territorin e komunës së Prizrenit. Periudha e zbatimit përfshin afatin një vjeçar, pra vitin 2013, me ç'rast paralogaria e DI-së për ekzekutimin e objekteve pa leje kap shumën prej 50 mijë eurosh. Rezultatet e pritura nga zbatimi i këtij vendimi në bazë të propozimit të DI-së janë: respektimi i zbatimit të planeve urbanistike, realizimi i ndërtimeve sipas standardeve dhe rritja e buxhetit komunal.

Ekzekutivi lokal ka miratuar edhe propozimet e Drejtorisë për Shërbime Publike për shpalljen e tenderëve për ndërtimin e rrugëve lokale në fshatrat: Bregdri, Kojush, Krajk, Vërmicë dhe Romajë, (paralogaria 260 mijë euro), ndërtimin e rrugës lokale dhe kanalizimin në fshatin Randobravë (50 mijë euro), ndërtimin e rrugës lokale në fshatin Petrovë (60 mijë euro), si dhe ndërtimin e rrugëve Piranë-Reti, Dedaj-Rugovë, Krushë e Vogël-Piranë. Edhe në rrugët e Arbanës parashihet rregullimi i trotuareve, pastaj zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës kryesore për në fshatin Poslisht, ndërtimi i kanalizimeve të fshatrave Mazrek (30 mijë euro) dhe Dobrusht (40 mijë euro).

Kanë kaluar edhe propozimet e Drejtorisë së Arsimit rreth shpalljeve të tenderëve si: Punimin e terrenit sportiv të SHFMU "Lidhja e Prizrenit" (paralogaria 30 mijë euro), Instalimin e ngrohjes qendrore të SHFMU "Heronjtë e Lumës" në Vërmicë (30 mijë euro), furnizimin me material shpenzues dhe ndërtimor për ushtrimin e punës praktike te nxënësve të SHMT "11Marsi" në vlerë prej 20 mijë eurosh. Ka kaluar edhe propozimi për shpalljen e tenderit për furnizim me inventar shkollor për vitin 2013, nga investimet kapitale, që kap llogarinë rreth 37,750 euro si dhe ndërtimin e dy klasave për mësim në SHFMU "Mushnikova" dhe në fshatin Drajçiq.

Janë miratuar edhe kërkesat e Drejtorisë së Administratës rreth lejimit të shpalljes së tenderëve për servisimin e veturave të tipit Golf 6 dhe Caddy (10 mijë euro), sikurse edhe furnizimi me material shpenzues për nevojat e komunës me vlerë prej 60 mijë eurosh.

Drita e gjelbër i është dhënë edhe Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale rreth shpalljes së tenderit për hartimin e planit dhe ndërtimin e banesave për familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës së UÇK-së.

Bordi i drejtorëve ka aprovuar edhe kërkesat e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik për rehabilitimin e rrugës turistike për në Kalanë e Kabashi dhe formimin e komisionit për identifikimin e objekteve (shtëpive) në Qendrën Historike të Prizrenit për rehabilitimin e fasadave.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
ëëë ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunës së Prizrenit" prej muajit shtator 2012
përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*